

LAURA SMAQI

**KRIJIMTARIA LETRARE E KIN DUSHIT
NË KONTEKSTIN E DEBATEVE MBI GJUHËN LETRARE
DHE GJUHËN E LETËRSISË NË VITET '50**

Marrëdhënia e letërsisë me dialektet është në një kuptim e ngjashme me marrëdhënien që ka vetë dialekti me gjuhën letrare. I konsideruar si një variant, përballë normës, raporti standard-dialekt në një kuptim do të duhet të ishte si raporti i të përgjithshmes me të veçantën. I tillë është dhe raporti mes standardit dhe letërsisë, e cila në themel të saj ka përdorimin e figurshëm të gjuhës, zbulon një aspekt të veçantë të saj si shmangie nga norma. Letërsia ekziston pikërisht prej së veçantës, është ajo tharmi i “ngjizjes” së saj.

Lidhjet më të natyrshme mes variantit poetik dhe atij gjuhësor kanë gjetur shprehje në krijimet popullore, të cilat ngahera krijoheshin dhe i drejtoheshin një rrethi njerëzish të një zone, që flisnin atë që konsideronin gjuhë, ndonëse realisht ishte një variant lokal i gjuhës. Kalimi në një gjuhë të përbashkët shkrimi në nivel kombëtar do të bënte që dëshira për një komunikim të gjerë, të çonte në përpjekje për të shkruar në atë mënyrë që poezia a proza, jo vetëm të ishte e kuptueshme përtej një zone të ngushtë gjeografike, por të transmetonte dhe emocionin e ndjeshmërinë poetike. Gjatë viteve '20-30 të shek. XX, bashkë me krijime të tilla të botuara, shkollat krijuan dhe një lexues të pregatitur për të lexuar gegërisht e toskërisht me të njëjtën dëshirë dhe pa paragjykime. Nga ana e shtetit merreshin vendime për gjuhën e administratës¹, por

¹ Komisia Letrare Shqipe, krijuar më 1916 shpalli në “Parime e rregulla mbi ortografin e gjuhës shqipe të shkrueme” se “si themel i ortografisë do të mirret dialekti i Elbasanit me disa ndryshime” R. Ismajli, *Gjuhë Standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, f. 54. Parimet themelore të kësaj Komisie u përfillën në Kongresin Arsimor të Lushnjes të 1920-ës. Në 1923-in Kryeministri autorizonte administratën që për bazë të gjuhës së

krijimtaria letrare ishte jashtë sferës së ndikimit shtetëror². Edhe tekstet shkollore dhe antologjitë respektonin gjuhën e autorëve, nga ata të shek. XV, tek bashkëkohorët. Tipik është botimi dyvëllimësh “Shkrimtarë shqiptarë” i vitit 1941, ku nxënësi njihej e studionte një histori të gjuhës e të gjuhës poetike shqipe, nga Buzuku e autorët e vjetër të veriut dhe jugut deri tek bashkëkohorët e krahinave të ndryshme, me ligjërimet përkatëse

Fundi i viteve ’40 dhe vitet ’50 paraqesin një tjetër pamje. Prof. Rexhep Ismajli ve në dukje se “*përsa i takon planifikimit gjuhësor ishin ndërmarrë hapa të rëndësishëm menjëherë pas Luftës së II Botërore.. Në janar të 1952-it ashpërsia e diskutimeve mbi bazën dialektore të gjuhës letrare shqipe u shfaq hapur në sesionin e parë “Mbi veprat e shokut Stalin mbi gjuhësinë dhe problemet tona gjuhësore në dritën e këtyre veprave.”*³ E njëjta situatë plot diskutime dhe orientime vijoi dhe në Sesionin e dytë shkencor për vitin 1952 të seksionit të Gjuhës dhe Letërsisë të Institutit të Shkencave.

Sipas Shuteriqit gjatë Luftës Nacionalçlirimtare toskërishtja si gjuhë shkrimi e kulture mbisundoi gjerësisht: “*juga nxorri udhëheqësit kryesorë e më të shumtët të lëvizjes: ajo dha kuadrot më të shumta*”⁴ Në gjendjen aktuale mendonte ai, përdorej kryesisht toskërishtja. “*Shtypi del toskërisht, propaganda e çdo lloji në këtë dialekt bëhet, duke nisë që nga radioja; gramatika shkencore, fjalori i shqipes që përpiloi Instituti i shkencave, atë kanë për bazë, përkthimet marksiste-leniniste n’ atë dialekt bëhen; edhe letërsia origjinale, në përgjithësi ashtu del.*”⁵

shkruar zyrtare të kishte të folmen e Elbasanit. I njëjti qëndrim u mbajt më 1928-ën, 1940-ën.

² Pavarësisht parimit e synimit që të vendosej një variant dialektor që të ishte më i afërt për të gjithë, “pati mjaft shkrimtarë gegë që nuk i përfillën vendimet e Komisionit. E respektonte Gurakuqi, por nuk e zbatuan Fishta e Mjedja, ndërsa Marlaskaj qysh në vitet ’20 i hidhte poshtë vendimet e Komisionit.”. Po aty, f. 55.

³ R. Ismajli, *Gjuhë standarte dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2005, f. 120.

⁴ Buletin për shkencat shoqërore I, 1952, f. 54-55.

⁵ Po aty, f. 55.

Pa u zgjatur në debatet e shumta⁶ për sa i takon dialektit, i cili sipas diskutuesve duhej vënë në bazë të gjuhës letrare, po përqendrohesh në disa pika që lidhen me gjuhën e letërsisë. Sipas Musarajit: *“Për shkrimtarin shtrohet pra, në mënyrë të veçantë detyra që ay të njohë gjithë rezervën e fjalëve, të shprehjeve, të figurave të cilëso krahinë t’atdheut dhe, nga kjo rezervë të dijë të bëjë seleksionimin e fjalëve dhe të strukturës së tyre estetike, të*

⁶ Po paraqesim shkurtimisht disa prej mendimeve të shprehura: Shuteriqi: *“Gjuhës sonë letrare i ka munguar **njëzimi**, që të mund të quhej një gjuhë e **vetme** shkrimi... Prandaj unë mendoj se nuk na shtrohet çështja e “formimit të gjuhës sonë nacionale letrare”, që thuhet se na “mungon”, po na shtrohet çështja e kryerjes së procesit të njëzimit të gjuhës sonë kombëtare letrare, të shkruar në bazë të dialektit jugor.”* Buletin i shkencave shoqërore IV, f. 33.

“...mendoj se folësi i njerit dialekt kur shkruan gjuhën letrare të bazuar te dialektit tjetër, e pasuron këtë gjuhë me fjalë, shprehje etj. që sjell nga dialekti i tij. Kjo është një rrugë shumë e sigurtë për pasurimin e gjuhës sonë letrare të vetme.” Po aty, f. 34.

“Krijimi i gjuhës nacionale letrare në kushtet tona nuk mund të bëhet në baza spontane, por në mënyrë koshiente, nën udhëheqjen e Partisë së punës dhe Qeverisë sonë, prandaj duhet ndjekur procesi i zhvillimit të së folmes toske, të cilën vetë zhvillimi historik e vuri në bazën e gjuhës sonë të vetme letrare dhe duhet pasuruar ajo me format e gegërishtes që janë të domosdoshme për gjuhën letrare nacionale” “normat e caktuara të bëhen të detyrueshme për shkollat, shtypin, radion e të tjera.” Po aty, f. 52-53.

Në pikën e VII të Referatit në lidhje me tezat për një gjuhë letrare të përzjerë e për një gjuhë letrare në bazë të gegërishtes jugore, shkruan:

“Teza e një gjuhe të përzjerë mpron alternativën më të keqe për krijimin e një gjuhe kombëtare letrare... Vetë historia e shkrimit të shqipes na jep disa shembujta përzjerje dialektesh e të folmesh pa shumë kriter, për formimin e një gjuhe të përbashkët letrare. Gjithë këto shembujta janë amalgame që nuk njohën asnjë sukses të vërtetë, që dështuan në të lindur.” Pasi përmend disa raste, vijon. *“Shpejt këto prova nisën të mërzhit botën. Më 1915 një patriot i mire i kohës Sali Nivica, duke folë kundër kësaj “mode të shkrimit”, kundër shkrimit “të përbashkët, një shkrim i përzjer, një shkrim për toskë e për gegë...një çorbë shkrimi” thotë se gjuha “nuk është miell që ta mbruin e ta pjekin pas qejfit një ose dy vetë”* Buletin i shkencave shoqërore IV, f. 36.

Në informacionin që jepet në Buletin shkruhet se *“Kolë Jakova kritikonte referatin e Shuteriqit...duke supozuar madje shkrirjen e dy dialekteve. Ai kishte kritikuar vendimet e Ministrisë së Arsimit për të futur abetaren vetëm toskërisht kudo në Shqipëri dhe gramatikën vetëm mbi bazë të toskërishtes. Propozonte të vazhonte shkrimi i dy dialekteve”* Po aty, f. 139.

ndjekë me kujdes zhvillimin e gjuhës, të studjojë leksikun duke analizuar formimin e fjalëve të reja dhe zhdukjen e ngadalshme të të vjetrave, të transformojë fjalët e huaja të domosdoshme, të cillave nuk u gjendet dot ekuivalenti i përshtatshëm në shqip, duke i veshur ato me tiparet e konstruktit fonetik e morfologjik, sipas ligjeve të gjuhës dhe të gramatikës sonë, gjë kjo e cila kërkon që shkrimtari të mos jetë i huaj ndaj njohurive të disa parimeve shkencore të gjuhës siç ndodh fatkeqësisht me shumë nga ne.⁷

Nëse në sesionin e parë, në diskutimin e tij Shuteriqi thoshte: “Mendoj se ne sot kemi një gjuhë kombëtare letrare. Unë nuk e shoh se si mund të quhet ndryshe gjuha e jonë e sotme e shkrimit që përdor administrate, shkenca, arsimi, shtypi e propaganda dhe pjesa m’e madhe e letërsisë artistike. A mund të thomi se ka sot në Shqipëri dy gjuhë shkrimi sepse një pjesë e letërsisë artistike nuk përdor gjuhën që përdorin gjithë sektoret e veprimtarisë shoqërore?”⁸, në sesionin e dytë, në mbrojtje të toskërishtes jo vetëm si gjuhë e administratës, shtypit, shkollës, propagandës do të shprehej:

“Thuhet se: është e vërtetë ndofta që këtë gjuhë shkrimi në bazë të dialektit jugor e marrin vesh të gjithë pa vështirësi; po vallë a e shkruajnë të gjithë pa vështirësi? Mua më duket se sot ka arritë puna që veriorët ta shkruajnë pa vështirësi gjuhën që ka në bazë dialektin jugor, jo vetëm n’administratë, në shkencë, n’arsim, në shtyp e në propagandë, po edhe në letërsinë artistike. Pa tjetër, kjo punë paraqit të meta të ndryshme. E meta kryesore nuk vjen nga fakti se “u thye tradita”, sepse më shumë se gjysma e atyre që shkruajnë sot, nuk kishin shkruar ndonjëherë më parë, – ishin fëmijë ose analfabetë. Kjo vjen kryesisht nga fakti se gjuha e shkrimit me dialektin jugor në bazë, nuk është bërë akoma sa duhet gjuhë e shkollës e nuk është njëzuar sa duhet.”⁹

Vija orientuese është mjaft e qartë në sektorët kryesorë të jetës dhe administratës. Por, në letërsinë artistike kuptohet që ndryshimi

⁷ Buletin i shkencave shoqërore I, f. 60.

⁸ Buletin i shkencave shoqërore IV, f. 32.

⁹ Po aty, f. 34.

do të vinte më ngadalë, e natyra e këtij ndryshimi do të shfaqte një varg problemesh. Në fushën e letërsisë, janë vetë shkrimtarët që mundohen t'i përgjigjen orientimeve, të cilat nuk kanë ende karakter detyrues. Letërsia nis të vihet në shërbim të konsolidimit, forcimit dhe vendosjes së një dialekti në pozicionin e standardit (quajtur gjuhë letrare). Rasti tipik është ai i Kin Dushit, jetëshkrimin e të cilit po e paraqesim shumë shkurt.

Lindi në Shirokë të Shkodrës, në 27 maj të 1922-it. I mbetur jetim, rreth moshës 10 vjeç dërgohet në jetimoren e Elbasanit. Në vitet 1936-1940 studion në “Normalen” e Elbasanit. Në vitet 1942-1944 është komisar i çetës së parë partizane të qarkut të Beratit. Në 1944-ën arrestohet nga gjermanët dhe dërgohet në kampin e Prishtinës. Më 1949-1952 studion në Bashkimin Sovjetik për letërsi. Pas përfundimit të studimeve punon si gazetar i “Zërit të Popullit” për zonën e Myzeqesë, më pas në gazetën “Bashkimi dhe si zv/kryeredaktor në gazetën “Ylli”. Më 1951 boton romanin e parë “Në gojën e ujkut”, mbi kohën e qëndrimit në kampin e Prishtinës. Më 1955 boton romanin “Udha e Velanit” dhe më 1961 “Kronikë e vendit tim”. Është laureat i çmimit të Republikës për letërsi në vitin 1955-1956, anëtar i kryesisë së Lidhjes së shkrimtarëve. Në vitin 1962 shkruan komedinë “Banorët e shkallës nr. 6”, gjithashtu dhe librete të shumta për Estradën e shtetit. Më 1964 boton romanin “Një emër në mes yjve”. Ky roman u kritikua për “deheroizëm” e konceptim anarkik për Luftën Nacionalçlirimtare në Plenumin e 15 të KQ të PPSH-së, dhe Kin Dushi arrestohet më 3 tetor 1967. Në vitin 1975 del nga burgu i Burrelit me shëndet të dobët, e punon në ndërmarrjen e ndërtimit “21 dhjetori” deri sa del në pension. Ndërron jetë në 6 prill 1994.

Gjithçka që ka botuar Dushi, me përjashtim të komedisë, është shkruar toskërisht, fakt ky mjaft mbresëlënës që e bën autorin të jetë një rast unikal në radhën e autorëve shqiptarë, në mënyrë të veçantë të atyre gegë, e në mënyrë akoma më të veçantë atyre shkodranë, me gjithë rrethanat specifike të jetës. Romani i parë i tij, “Në gojën e ujkut”, që lidhet me periudhën e jetuar në kampin e Prishtinës, në aspektin gjuhësor shfaqet mjaft i unifikuar. Në libër nuk ka asnjë të dhënë për prani redaktorësh e korrektorësh, dhe gjuha nuk duket se

“sforcohet” në rrjedhën e saj në roman. Kemi të bëjmë fund e krye me një toskërishte të unifikuar, ku edhe trajta të njëhershme të tipit *kaqë* dhe *kaq*, janë të pakta.

Romani i dytë, “Udha e Velanit”, botuar më 1955-ën ve në qendër krijimin e kooperativës në zonën e Velanit. Nuk bëhet fjalë për Velanin e veriut të Shqipërisë, por për një zonë jugore në Myzeqe me të njëjtin emër. Ndoshta njohja me këtë zonë, (si korrespondent i “Zërit të Popullit” për Myzeqenë), ngritja e kooperativave të para si bosht kryesor i romanit e po ashtu dhe emri i njëjtë me Velanin e Kelmendit, e ka shtyrë autorin shkodran ta vërë këtë emër. Por kjo është e vetmja pikë e përbashkët, sepse duke qenë një mjedis jugor, gjithçka në roman do ta “detyronte” autorin të shkruante në toskërisht. Dushi, siç e vumë në dukje, ka pasur një formim të mirë përta i takon toskërishtes, por në këtë roman, ndryshe nga romani i parë ku lexuesit i krijohet përshtypja e një autori jugor, që gjatë gjithë kohës shkruan toskërisht, këtu në disa momente gati theksohen aspektet “jugore” të shqipes, (sidomos me ë-të e shumta e ndonjëherë dhe me ç-të), (*S’ia bënin kurrë fjalën dyshë. Kaqë i prapë ishte.*). Elemente të gegërishtes shfaqen që në fillim, por nuk janë dominante. Më pas gjuha është më pranë standardit të sotëm, por në gjithë romanin ka lëkundje mes toskërishtes e gegërishtes, jo rrallë edhe brenda një fjalie duke i dhënë romanit natyrën e një krijimi të shkruar nga dy njerëz të ndryshëm. *Nuk ke gojë të flasish, e? Tonçit i dolli gjak nga hundët, s’çelte gojë, fshehurazi nga babaj*¹⁰. *Hidhëte gurë rrasikë n’ujë, n’atë bar jo aqë të shkelur.*¹¹

*Babajt të Lonit i vinte të vriste vehten, Ore, po kujt i llaforesh ti ashtu? – Ty, ore, pse ta kam frikën, a? ... Tili dëgjonte me vrejtje dhe s’bëzante e, kur vinte fjala te Vangjelia, ai tundëte kokën e vinte buzën në gaz si gjithëherë.*¹²

Edhe në këtë botim, nuk shkruhet se ka redaktor apo korrektor, siç do të ketë përmbledhja me tregime dhe përshkrime “Kronikë e

¹⁰ K. Dushi, Udha e Velanit, “Ndërmarrja Shtetërore e botimeve”, 1955, f. 5.

¹¹ Po aty, f. 4.

¹² Po aty, f. 178.

vendit tim” e 1961-it dhe romani tjetër “Një emër midis yjve” të shkruara po toskërisht.

Në lidhje me romanin “Udha e Velanit”, do të doja të sillja në vëmendje çfarë shkruante Camaj nga Italia, në Shejzat e vitit 1960, përse i takon analizës së aspektit gjuhësor të këtij romani¹³.

Fillimisht, megjithëse nuk ka të dhëna biografike, vetëm duke gjykuar nga gjuha, besoj dhe nga emri, Camaj thotë se Kin Dushi duhet të jetë shkodran, por që ka jetuar në Toskëri, ku ka përvetësuar mjaft gjuhën e folur e jo atë të shkrimtarëve toskë. Megjithatë romancieri mbetet gegë në përmbajtjen më intime të tij. Sipas Camajt në pikëpamje të gjuhës romani i K. Dushit paraqitet tejet interesant. Një pjesë e madhe e fjalorit dhe e frazeologjisë së tij lidhet ngushtë me trashëgiminë letrare të Veriut të Shqipërisë dhe veçanërisht atë të Shkodrës. Duke marrë shkas nga ky roman ai ve në dukje se shkrirja e dy dialekteve në një gjuhë të përbashkët letrare që duhet të ketë përciptas trajtat e toskërishtes, nuk është çështje e veçuar apo eksperiment i një shkrimtari të Tiranës, por një masë e shtetit shqiptar që është vënë në fuqi në administratë e në letërsinë e pasluftës. Dushi kërkon ta vërë në jetë këtë masë, por me gjithë vullnetin e mirë, në vend që të bëjë një shkrirje, i përzien elementet e dy dialekteve. Duke marrë shkas nga ky roman Camaj ve në dukje se letrarët, si gegë, si toskë, po përpiqen të krijojnë një gjuhë shkrimi në themelet e dialektit të Jugut, duke shtënë një mori lënde gjuhësore të Veriut, sidomos të traditës letrare të Shkodrës, por përfundimet janë të dobëta. Megjithëse procesi i kësaj shkrirjeje artificiale të dy dialekteve në një, është në fazën fillestare, sipas tij dalin në pah dy fakte:

1 - kjo gjuhë nuk përfaqëson asnjë krahinë të Shqipërisë, as nuk është shprehje e të folmes së Tiranës së viteve ‘60, ku prej dhjetë vitesh gjallojnë të gjitha të folmet e Shqipërisë.

2 - toskërishtja, e cila është e shtrënguar të pranojë në gjirin e vet trajta e ndërtime të papërshtatshme për natyrën e shijen e saj, pëson dëmin më të madh. Kjo ndodh sidomos kur një gegë shkruan në

¹³ “Rreth prozës së sotshme në Shqypni”, Shejzat 1960, nr. 9-10, f. 291-299.

dialektin e Jugut, në këtë rast stili i tij merr një ngjyrë të *pabukur* përkthimi.

Të njëjtën çështje Camaj e rimerr edhe në artikullin tjetër “Mendime rreth zhvillimit të letërsisë së mbasluftës në Shqipëri”, *Shëjzat*, 1966, nr. 9-12. Ripërsëritet mendimi i shprehur mbi trajtën gjuhësore të kësaj letërsie të re, përpjekja për të krijuar një gjuhë të re të unifikuar shkrimi me të gjitha mjetet e një aparati burokratik shtetëror.

Gjatë viteve '50 kujtojmë se janë botuar dhe krijime në poezi e dramë të K. Jakovës, (*Halili dhe Hajria* 1950, *Herojt e vigut* 1953, *Toka jonë* 1955, *Flladi i tetorit: frymëzime nga lufta për çlirimin e Tiranës*, 1956.) shkruar gegërisht, me lëvizje të moderuara. Po ashtu krijimet e përkthimet e Drago dhe Llazar Siliqit ishin në gegërisht. Kin Dushi është i vetmi autor shkodran që ka shkruar tre romane dhe një përmbledhje tregimesh e përshkrimesh në toskërisht, duke eksperimentuar e krijuar një gjuhë që vështirë të jetë pjesë e identitetit të tij si individ. Puna e tij u përshëndet dhe u vlerësua nga udhëheqja e kohës e jo pa arsye, Kin Dushi merr çmimin e Republikës në letërsi në vitin 1955-56, periudhë kjo e botimit të romanit “Udha e Velanit”, ku bashkohej tema e trajtuar me gjuhën e veprës.

Si përfaqësues i brezit të parë të shkrimtarëve që vinin nga Lufta e që pas shkollimit në B.S konsideroheshin kuadro që e kishin për detyrë emancipimin e shoqërisë dhe dhënien e shembullit personal, Kin Dushi, me idealizmin që ia dëshmojnë të gjithë ata që e kanë njohur, u mundua të japë kontributin e tij në letërsinë e re të pasluftës, duke qenë pararojë e orientimeve që shpalleshin. Paradoksalisht dhe për fat të keq, më pas do të jetë pikërisht letërsia, dhe këmbëngulja për të mos bërë ndryshimet që i kërkoheshin në romanin “Një emër midis yjve” të cilat do t'i ndryshonin gjithë rrjedhën e jetës.